RAPORTI VJETOR I AKTIVITETIT

EITI 2014

Sekretariati Shqiptar EITI

Përgatitur nga:

EITI Shqiptar

Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

Shkurt 2015

EITI Albania
Adresa: Bulevardi Zhark Dark, Ish godina ME, Kati IV., Tirana, Albania Tel : +355 4 2264645, sekretariati@albeiti.gov.al
www.albeiti.org

1 Një vlerësim i përgjithshëm i performancës vjetore

Viti 2014 ishte një sfidë për Sekretariatin Shqiptar EITI. Afati 6 mujor që ju la Shqipërisë nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI për publikim e Raportit EITI 2011 nxiti të gjithe grupet e interesit për të përmbushur këtë detyrim themelor të Nismës EITI. Me kalimin e grandit nga Banka Botërore dhe angazhimit të Qeverisë Shqiptare për promovimin e transparencës në industrinë nxjerrëse, brenda vitit u bë e mundur përgatitja dhe publikimi i dy raporteve EITI, Raporti EITI 2011 i cili u publikua më 27 qershor 2014 dhe Raporti EITI 2012 i publikuar më 21 nëntor 2014.

Publikimi i raporteve brenda afateve kohore te përcaktuara u arrit nëpërmjet rolit intensiv që luajti MSG në këtë proçes. Bordi EITI tregoi një angazhim të madh duke zhvilluar në muajt e parë të vitit 2014 një sërë takimesh me të gjithë grupet e interesit. Gjithashtu përmendim faktin se përpara publikimit të Raportit EITI 2011 Banka Botërore me përfaqësuesin e saj z. Edon Vrenezi, zhvilloi një takim me Bordin Shqiptar EITI, ku u pa qartë një bashkëpunim i frytshëm mes këtyre dy institucioneve.

Me mbështetjen e Prezencës së OSCE në Shqipëri, më 24 prill u mbajt Forumi Kombëtar EITI me temë "Promovimi i Nismës EITI dhe përfitimet publike në nivel vendi". Ky forum kishte për qëllim krijimin e një platforme diskutimi dhe gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimit për autoritetet e qeverisë qendrore dhe lokale dhe bisneseve, në mënyrë që të rrisin të mirat publike që vinë nga industria nxjerrëse nëpërmjet projekteve ekonomiko-sociale. Pjesëmarrës në këtë forum ishin si: Ministri i Energjise dhe Industrise Z. Damian Gjiknuri, Zv. Ministri i Energjise dhe Industrise dhe Kryetar i Bordit EITI, Z. Ilir Bejtja, Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara te Amerikës, Alexander Arvizu, Ambasador i Prezencës së OSCE në Shqipëri, Z. Florian Rauning, Kryetari i Komisionit Parlamentar i Aktiviteteve Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit z. Eduart Shalsi dhe Zv. Ministri i Financave Z. Ervin Mete. Gjithashtu të pranishëm ishin përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të drejtorisë së doganave dhe tatimeve, përfaqësues të ambasadave të vendeve të huaja në Shqipëri, përfaqësues të kompanive të industrisë nxjerrëse (të naftës, gazit dhe minerareve) si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor.

Në kuadër të përgatitjes së raportit EITI 2011, në muajin Maj 2014 u zhvilluan një sërë takimesh me institucionet qëndrore si Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave. Administratori i Pavarur Deloitte Albania, me mbështetjen dhe

pjesëmarrjen e Bordit EITI zhvilloi një takim me kompanitë raportuese në raportin EITI 2011, në lidhje me plotësimin e formularëve raportuese të deklarimit të të dhënave. Të njëjtat aktivitete u zhvilluan me grupet e interesit në muajin Korrik 2014 për raportin EITI 2012.

Më 29 Korrik nga Qeveria Shqiptare u organizua një aktivitet "300 Ditët e Energjisë dhe Industrisë" , ku Sekretariati Shqipëtar EITI prezantoi veprimtarinë e tij dhe punën e kryer përgjatë vitit 2014.

EITI Shqiptar prezantoi identitetin e tij të ri vizual me një faqe të re interneti për vijimin e veprimtarisë së Sekretariatit, në një fazë të re të zhvillimit. Identiteti i ri vizual i EITI Shqiptar konsiston në një logo të re dhe në një faqe të re interneti.

Sekretariati Shqiptar EITI rinisi një fushatë të re promovimi të Nismës EITI duke bashkëpunuar me shoqërinë civile dhe me organizata ndërkombëtare si OSCE, duke zhvilluar takime në nivel vendor në zonat e industrisë nxjerrëse si Patos, Bulqizë.

Në muajt Shtator – Tetor Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi një anketë në qëndrat kryesore të industrisë nxjerrëse në Shqipëri, Bulqizë, Kukës, Patos, Përrenjas, Librazhd si dhe në kryeqytet, Tiranë për të parë impaktin që ka Nisma EITI në shoqëri. Rezultatet e anketës treguan që popullsia shqiptare ka njohuri minimale ndaj Nismës EITI.

Për të ndërgjesuar publikun lidhur me situatën aktuale të industrisë nxjerrëse në vend dhe rolin EITI ne industrinë nxjerrëse, Sekretariati për periudhen Nentor 2014 – Qershor 2015 përgatiti një Strategji te re Komunikimi për EITI-n Shqiptar.

2 Vlerësimi i performancës kundrejt objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës

Në Planin e Punës EITI 2014, Sekretariati dhe MSG përcaktuan detyrat që duhet të arrihen, si dhe objektivin kryesor, ai i përgatitjes dhe i publikimit në afatet e përcaktuara të Raporteve EITI 2011 dhe EITI 2012.

Objektivi 1 Përpilimi i planit të punës në përputhje me standartet e reja EITI

Përpilimi i planit të punës në përputhje me standartet e reja EITI ishte baza e nisjes së punës për vitin 2014. Sekretariati Shqiptar EITI dhe MSG përgatitën Planin e Punës 2014 ku përcaktuan detyrat dhe objektivat e vitit.

Objektivi 2 Riorganizimi i MSG dhe njohja me rregullat dhe standartet e reja EITI

MSG në vitin 2014 pati ndryshime. Disa anëtarë u larguan për shkak të obligimeve të tjera. Sekretariati dhe Kryetari i MSG e panë të nevojshme plotësimin e vendeve vakante në Bord dhe njoftuan istitucionet përkatëse për të propozuar anetarët e rinj.

Anetarët e rinj u njohën ne fillim të vitit 2014 me Standartet e Reja EITI, ku një ndër pikat kryesore të këtij Standarti është edhe publikimi në kohë i Raporteve EITI, ku të gjithë anetarët e MSG, uninanimisht shprehën shqetësimin dhe angazhimin e tyre të plotë për publikimin në kohë të Raporteve EITI brenda vitit 2014.

Objektivi 3 Përgatitja e TOR dhe përzgjedhja e Administratorit të Pavarur

Kryetari i MSG, z. Ilir Bejtja, zv. Ministër i Energjisë dhe Industrisë, tregoi një angazhim të madh kundrejt bashkëpunimit të të gjitha institucioneve shtetërore që marrin pjesë në proçesin EITI.

Në Termat e Referencës së raporteve EITI 2011 dhe EITI 2012, MSG unanimisht ra dakort për rritjen e pragut të materialitetit në përzgjedhjen e kompanive të sektorit minerar nga 500 mijë në 750 mijë USD, ndërsa për sektorin e naftës përfshirjen e të gjitha kompanive aktive (kërkim dhe prodhim) në këtë sektor.

Për të arritur raportimin brënda afateve të përcaktuara, ne Maj 2014 u bë përzgjedhja e Administratorit të Pavarur, Deloitte Albania, në përputhje me proçedurën e tenderimit të Bankës Botërore.

Objektivi 4 Sigurimi i një legjislacioni të qëndrueshëm për zbatimin EITI në Shqipëri

MSG dhe Sekretariati propozuan ndryshime në legjislacion dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me propozimin e Këshillit të Ministrave vendosi disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 134/2014, date 09.10.2014 per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 10304 date 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar, ku në Nenin 21 në fund të pikës 25 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në funksion të veprimtarisë së saj, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion nga subjektet zotëruese të lejeve minerare, organet e administratës tatimore e doganore dhe organet e qeverisjes vendore, si dhe të publikojë në raportin vjetor të dhëna që kanë të bëjnë me pagesat e detyrimeve fiskale, të kryera nga subjektet minerare."

Ky ndryshim i ligjit për sektorin minerar pasqyron përmirësime, duke eleminuar pengesa në raportimin dhe rakordimin e të dhënave me subjektet private dhe agjencitë qeveritare.

Në muajt Maj – Qershor 2014 u nënshkruan memorandumet e mirëkuptimit me kompanitë e naftës, gazit, Drejtoritë e Përgjithshme të Doganave dhe Tatim Taksave, për zbatimin e standarteve EITI, deri në përmirësimin e bazës ligjore.

Objektivi 5 Njohja e grupeve të interesit me rezultatet e raportit EITI 2011 dhe EITI 2012

Më 27 qershor 2014 u publikua Raporti EITI 2011, përgatitur referuar Standartit të Ri EITI 2013. Më 21 nëntor 2014 u publikua Raporti EITI 2012, i përgatitur referuar Standartit të Ri EITI 2013, duke u bërë kështu Raporti i katërt EITI që Sekretariati Shqiptar EITI publikon.

Keto raporte u diskutuan dhe miratuan në takimet e Bordit EITI.

Raportet EITI 2011 dhe EITI 2012 u publikuan në faqen zyrtare EITI Shqiptar.

Iu dërguan me postë elektronike tek përfaqesuesit e kompanive, njësive vendore, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit.

Këto raporte u prezantuan nga drejtuesja e Sekretariatit Shqiptar EITI, Znj. Dorina Çinari, në median e shkruar dhe vizive.

Qershor 2014 Gazeta Shqip, gazete e perditshme

Drejtuesja e Sekretariatit Shqiptar EITI më datë 8 gusht 2014 jep një intervistë në gazetën e përditshme *Shqip*. Znj. Çinari shpjegon se "publikimet e EITI Shqiptar kanë të bëjnë me të ardhurat që gjeneron Shteti Shqiptar nga përdorimi i burimeve natyrore të vendit : nafta, gazi, dhe minierat Kompanitë operuese në këtë sektor publikojnë çfarë ata i paguajnë shtetit (taksë, rentë etj.) dhe këto të dhëna rakordohen me të ardhurat e deklaruara nga shteti."

Korrik 2014 – Monitor, reviste e konomike

Më 20 Korrik 2014, Znj. Çinari, dha një intervistë në revistën ekonomike Monitor.

Drejtuesja e Sekretariatit u shpreh për ndikimin e kësaj nisme, gjetjet e raportit të fundit 2011, si dhe masat që duhet të merren për të "shpëtuar" këtë sektor, potenciali i të cilit është tejet i madh.

Dhjetor 2014 – Vizion Plus, emisioni 7 pa 5

Formati informativ, i cili sjellë çdo mëngjes informacione në televizionin Vizion Plus, "7 pa 5" , intervistoi direkt me datë 5 dhjetor 2014 znj. Çinari, Drejtuesja e Sekretariatit Shqiptar EITI, duke orientuar vemendjen e audiencës dhe duke synuar të nxisë tek ajo një prezantim se çfarë është dhe çfarë funksioni luan Nisma EITI në Shqipëri.

4 Dhjetor 2014 konferenca per shtyp EITI Shqiptar publikon Raportin EITI 2012

EITI Shqiptar më 4 dhjetor 2014 publikoi Raportin EITI 2012. Ky Raport përbën dhe Raportin e katërt EITI për Shqipërinë duke pasqyruar kontributin e industrisë nxjerrëse në buxhetin e shtetit, si dhe shpërndarjen dhe shpenzimin e këtyre të ardhurave me qëllimin përfundimtar të promovimit të transparencës.

Objektivi 6 Raportimi i aktiviteteve vjetore 2013

Qershor 2014 Sekretariati Shqiptar EITI dorëzoi raportin e parë të aktiviteteve vjetore për 2013. Raporti u pergatit referuar në kërkesat e standartit të ri EITI. Raporti bëri një vlerësim të performancës gjatë vitit 2013 referuar objektivave të planit të punës 2013 ku sekretariati ndërmori aktivitete kryesisht në zonat e industrisë nxjerrëse.

Objektivi 7 Ndergjegjesimi i opinionit publik ndaj transparences

Në periudhën 23 shtator - 13 tetor 2014, Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi një ankete mbi impaktin EITI ne komunitet, konkretisht se sa njohuri kanë qytetarët rreth industrisë nxjerrëse në përgjithësi dhe rreth Sekretariatit EITI Shqiptar. Anketimi u zhvillua në komunitetet ku kryesisht operon industria nxjerrese si: Tiranë, Kukës, Bulqizë, Patos, Librazhd dhe Perrenjas.

Në secilën prej zonave të sipërpërmendura janë anketuar 100 qytetarë duke përfshirë specialiste të Administratës Shtetërore, specialistë të Bashkive dhe Komunave, nxënës të shkolla të mesme, studentë, minatorë, naftëtarë, policë, organizata të Shoqërisë Civile, gazetarë, qytetarë, pra në një total prej 500 të anketuar.

Plotësimi i formularëve të anketës u bë nga vetë stafi i sekretariatit, në mënyrë që gjatë kontaktit me qytetarët të jepej informacion mbi EITI dhe Sekretariatin Shqiptar. Gjithashtu personave të takuar si

dhe në të gjitha institucionet që kemi vajtur si në shkollat e mesme, bashki, spitale, kompani të industrisë nxjerrëse ne kemi shpërndarë fletepalosje dhe broshura informuese mbi EITI Albania.

Në qytetin e Bulqizës dhe Patosit u zhvilluan seminare në fillim të vitit 2014, ku të pranishëm perveç grupeve të interesit ishin dhe qytetarë të zonave. Në këto aktivitete u shpërndanë fletepalosje dhe broshura.

Objektivi 8 Programe trajnimi për stafin e EITI Shqiptar

Sekretariati Shqiptar EITI është një institucion në varësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ofroi trajnim për administraten publike ku mori pjesë dhe stafi i Sekretariatit EITI.

Në takimet e para të vitit 2014, anëtarët e rinj të Bordit nga institucionet përkatëse u njohën me standartin e ri EITI.

Në seminaret që janë mbajtur në zonat e Bulqizës dhe Patosit, përfaqësuesit e pushtetit lokal kanë marrë informacion mbi të drejtat e komunitetit, përfitimet nga industria nxjerrëse, renta minerare, etj.

Gjithashtu përmendim faktin se Znj. Çinari, përgjatë viti 2014 mori pjesë në disa takime ndërkombëtare si më poshtë;

- Oslo-Norvegji, më 24-27 shkurt 2014 me temë "Prezantimi i hapave për antarësimin në EITI"
- Bruksel-Belgjikë, më 08-11 shtator 2014 me temë "Tatimi i industrisë nxjerrëse"
- Myanmar-Azi, më 13-17 tetor 2014 me temë "Workshop mbi të dhënat EITI"
- Athinë-Greqi, më 30 Shtator – 03 Tetor 2014 me teme " Takim i vendeve të Ballkanit për naftën dhe gazin"

Objektivi 9 Përhapja e Informacionit

Forumi Kombëtar EITI me temë "Promovimi i Nismës EITI dhe përfitimet publike në nivel vendi", i mbajtur më 24 prill, kishte për qëllim krijimin e një platforme diskutimi dhe rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve qeverisëse dhe bisneseve ndaj transparencës në industrinë nxjerrëse.

Takimi i mbajtur më datë 29 korrik, organizuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me pjesemarrjen e të gjitha institucioneve te varësisë, me temë "300 ditët e Energjisë dhe Industrisë" , ku

Sekretariati Shqiptar EITI prezantoi punën e kryer. Përmendim faktin që ky takim ishte në transmetim direkt në të gjitha mediat shqiptare, ku raportohen lajmet në kohë reale.

Konferenca për shtyp që u mbajt me zëvendës ministrin z. Bejtja dhe znj. Çinari për raportin 2012, u shpërndanë për të gjithë të ftuarit në nivel lokal dhe qëndror një njoftim për raportin EITI 2011 dhe EITI 2012 bashkalidhur me një CD të raportit EITI.

Objektivi 10 Krijimi i strategjisë së komunikimit për vitin 2015

Sekretariati zhvilloi një anketë në komunitetet e industrisë nxjerrëse në Shqipëri si; Bulqizë, Patos, Librazh dhe në Tiranë si kryeqëndra e Shqipërisë.

Rezultatet e anketës treguan që njohuritë për nismën EITI tek popullsia janë minimale. U pa nevoja e menjëhershme e krijimit dhe zbatimit të një Strategjie të re Komunikimi. Sekretariati përzgjodhi një Konsulent Individual për përgatitjen e Strategjise së Komunikimit.

Në strategjinë e komunikimit është përpiluar një plan konkret veprimi me aktivitete që duhet të ndërmerren për të rritur impaktin në shoqëri.

Strategjia e Komunikimit gjendet në faqen tonë të website dhe synon ti bëjë aktorët dhe publikun e gjerë, më të ndërgjegjshëm për situaten dhe potencialin që ka industria nxjerrëse, duke rritur kështu mundësinë për më shumë llogaridhënie, dhe për më shumë transparencë duke i bërë operatorët e industrisë nxjerrëse tu përgjigjen më shumë nevojave dhe kërkesave të komuniteteve.

Objektivi 11 Studim mbi kapacitetet potenciale te te ardhurave nga industria nxjerrese

Për informimin e publikut dhe zgjerimin e transparencës mbi të ardhurat potenciale nga industria nxjerrëse Sekretariati ka nisur një serë studimesh si Studimi për të ardhurat potenciale në industrinë nxjerrëse; Studim mbi potencialin dhe përfshirjen e sektorit të hidroenergjisë në raportet EITI dhe Studimin mbi sistemin e integruar të të dhënave EITI.

3 Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI

Shqipëria publikoi në 2014, dy Raportet EITI 2011 dhe EITI 2012, bazuar në Standartin e Ri EITI. Sipas kërkesave të Standartit të ri EITI, të liçensuarit dhe institucionet qeveritare raportuan përkatësisht pagesat e kryera dhe të ardhurat vjetore të arkëtuara. MSG dhe Sekretariati Shqiptar EITI kërkuan të

raportohen pagesat nga të gjitha shoqëritë e liçensuara që vepronin në kërkimin e naftës, gazit dhe mineraleve; të gjitha shoqëritë e liçensuara që vepronin në prodhimin e naftës dhe gazit si dhe prodhuesit më të mëdhenj në sektorin minerar. Gjithashtu, MSG dhe Sekretariati Shqiptar EITI i kërkuan institucioneve qeveritare të raportojnë të ardhura që kanë arkëtuar nga këto shoqëri.

Vlerësimi i kërkesave EITI në Raportet përkatëse

Kërkesa:	Progresi:
1. Menaxhimi i të ardhurave, grumbullimi dhe shpërndarja e rentës minerare (Kërkesa 3.7 - 3.8)	MSG dhe EITI Shqiptar kane evidentuar se deri me tani shperndarja e rentes minerare eshte bere vetem per zonat e prodhimit te naftes dhe jo ne zonat minerare, lidhur me kete jane diskutuar permiresimet ligjore ne mënyren e shpërndarjes së rentës. Ligji nr. 157/2014 date 27.11.2014 per taksat kombetare, ka pasqyruar pikërisht këto përmirësime ligjore. EITI Shqiptar ka nisur ne Shtator 2014 studimin per Vleresimin e Potencialit te te Ardhurave nga Industria Nxjerrese.
2. Shpenzimet Sociale (Kerkesa 4.1.e)	MSG dhe EITI Shqiptar kane diskutuar me kompanite dhe institucionet shteterore perkatese si Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN), lidhur me pasqyrimin ne raportin EITI 2013 te te dhenave mbi shpenzimet qe kompanite kane kryer si shpenzime sociale, per mbeshtetjen e komunitetit.
3. Përfshirja e pagesave nën-kombëtare (Kërkesa 4.2.e)	Në raportet EITI 2011 dhe EITI 2012 janë evidentuar dhe përfshirë pagesa nën-kombëtare për tatimet, doganat, dhe rentën.
4. Perfituesit e pronesise (Kerkesa 3.11	Në raportet EITI 2011 dhe EITI 2012 janë evidentuar dhe përfshirë te dhenat e raportuara nga Albpetrol sha (e vetmja kompani me pronesi shteterore).
5. Transparenca me kontratat (Kërkesa 3.12)	Kontratat e industrise minerare janë të evidentuara publikisht në Qëndrën Kombëtare të Liçensimit (QKL) gjithashtu një pjesë e të dhënave teknike (hartat)për këto kontrata janë të publikuara në website të AKBN. Po diskutohet të bëhet permiresimi i bazes ligjore per publikimin e kontratave te industrisë se naftës.

4 Përmbledhje e përgjigjeve të MSG për rekomandimet nga rakordimi dhe validimi, nëse është e aplikueshme

Rekomandimet e Raporti EITI 2011 janë diskutuar në MSG si më poshtë:

Rekomandimi 1 Zbatimi i rekomandimeve të vitit të mëparshëm

Rritja e materialitetit në mënyrë që rakordimi të përqëndrohet vetëm tek flukset e parasë nga subjektet e mëdha dhe marrja në konsideratë e deklarimeve të njëanshme për operatorët më të vegjël. Xhiro vjetore, si kufi i materialitetit për përzgjedhjen e të liçensuarve në prodhimin e mineraleve u rrit nga 500,000 USD në 750,000 USD. Kjo solli dhe zvogëlimin e numrit të të liçensuarve deklarues nga 81 në 53, por nuk pati ndonjë ndryshim të rëndësishëm në peshën specifike të të ardhurave të deklaruara nga kompanitë minerare.

Me qëllim rritjen e aksesit në kohë, në të dhëna të besueshme, administrator i mëparshëm rekomandoi caktimin e pikave të kontaktit EITI në agjencitë qeveritare dhe në kompanitë e mëdha, gjë e cila është realizuar. Pengesat në aksesin e të dhënave të besueshme dhe gjithëpërfshirëse nga pushteti vendor dhe rakordimi i tyre me deklarimin e bërë nga subjektet private, është rekomanduar të behet i njëanshem dhe të merret drejtpërdrejt nga strukturat e pushtetit vendor (Bashkitë dhe Komunat), që do të zbatohet në raportet pasardhëse.

Rekomandimi 2 Përforcimi i kuadrit regullator për raportimin EITI

Rregullimi aktual i EITI bazohet në Ligjin Minerar nr 10304 datë 15.07.2010 dhe VKM nr. 233, datë 23 mars 2011. Për sektorin e naftës dhe gazit, kërkesat për deklarimin dhe publikimin e të dhënave EITI rregullohen me Marrëveshjet e Mirëkuptimit të firmosura midis Sekretariatit dhe çdo shoqërie në këtë sektor. Rregullimi aktual i EITI përmend detyrimin për raportim të subjekteve të liçensuara, por nuk përcakton detyrimet raportuese të institucioneve qeveritare mbledhëse dhe nivelit të detajimit të të dhënave që mund të publikohen. Pengesat që u hasën gjatë këtij proçesi janë propozuar nga Sekretariati dhe MSG që mund të kapërcehen nëpërmjet përmirësimeve ligjore nën Ligjin Nr. 10304, datë 15.07.2010. Deloitte Albania, rekomandon që raportimi i pagesave dhe niveli i detajimit të tyre të autorizohet nga ky ligj i përmirësuar dhe udhëzimet shoqëruese. Në rastin e sektorit të hidrokarbureve, ky aprovim mund të shprehet në një shtojcë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të firmosur ndërmjet shoqërive të naftës dhe EITI në Shqipëri. Në mënyrë që të jetë në përputhje me proçedurat aktuale tatimore dhe

doganore, kjo shtojcë e Marrëveshjes së Mirëkuptimit është propozuar të firmoset gjithashtu edhe nga institucionet qeveritare arkëtuese, gjë e cila nuk ka patur kundërshtime.

Rekomandimi 3 Caktimi i një proçesi vjetor të skeduluar për raportimin EITI

Në mënyrë që të lehtësohet puna rakorduese dhe raportuese, rekomandohet nga Deloitte Albania caktimi i një skeduli vjetor për proçesin e rakordimit si në vijim: përditësimi, publikimi i formularëve dhe udhëzimeve si dhe përzgjedhja e subjekteve deklaruese dhe caktimin e një afati për dorëzimin e deklaratave dhe punës rakorduese.

Rekomandimi 4 Rakordimi i pagesave për gjobat

Shoqëritë e liçensuara dhe institucionet qeveritare raportuan pagesat për penalitete nga rivlerësimi tatimor në shumën 200 milion Lek, përkrah atyre treguesve të tjerë që ishin kërkuar. Ky fluks të ardhurash paraqitet i lartë dhe i rëndësishëm në krahasim me pagesat e tjera. Për këtë arsye Deloitte Albania rekomandon që MSG të konsiderojë përfshirjen e këtij treguesi në rakordimin e pagesave në të ardhmen, gjë e cila është zbatuar në Raportin EITI 2012.

Rekomandimi 5 Akses në të dhëna të besueshme dhe në kohë nga Shteti

Caktimi i pikave kryesore të kontaktit EITI në institucionet shtetërore, ndikon pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit dhe koordinimit të aktiviteteve EITI. Megjithatë, rekomandohet se duhet të bëhet më shumë për të përmirësuar raportimin dhe analizat e aktivitetit të industrisë nxjerrëse dhe flukseve të parasë. Për të përmirësuar plotësinë dhe saktësinë, besueshmërinë dhe aksesin në informacionin kontekstual, Deloitte Albania rekomandon që Ministria e Energjisë dhe Industrisë të publikojë në mënyrë periodike (të paktën çdo vit) fakte mbi industrinë nxjerrëse duke përfshirë: potencialin e industrisë dhe prodhimin aktual, kontributin në ekonomi, strategjinë e sektorit, ngjarje dhe fakte, rregullimin aktual dhe ndryshimet e ardhshme etj. Informacioni i përditësuar nga sistemi raportues i Shtetit do të përmirësojë statistikat për sektorin dhe do të mund të krahasohet me informacione të tjera si struktura e industrisë nxjerrese, niveli i prodhimit, numri i te punesuarve , kontributet shoqerore, numri i liçensave, investimet e parashikuara dhe te kryera, realizimi i mbrojtjes se mjedisit, renta e grumbulluar dhe e shperndare ne zonat e industrise nxjerrese, transferta vullnetare per qeverisjen vendore ne zonat e industrise nxjerrese etj.

Rekomandimi 6 Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së statistikave për sektorin

Në kontekstin e përmirësimit të raportimit dhe statistikave për industrinë nxjerrëse, Deloitte Albania i rekomandon Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të konsiderojë zbatimin e këresave për raportime të ngjashme me ato që përfshin Direktiva e Bashkimit Europian për Kontabilitetin dhe Transparencen. Bazuar në këto kërkesa, shoqëritë e liçensuara mund të paraqesin pagesat per raportimin EITI në një aneks të pasqyrave financiare, problem i cili po diskutohet për tu paraqitur në institucionet qeveritare për qëllimin EITI.

Rekomandimet e Raporti EITI 2012 janë diskutuar në MSG si më poshtë:

Rekomandimi 1 Forcimi i aksesit në të dhëna cilësore dhe të besueshme

Deloitte Albania rekomandon që për publikimin e të dhënave të detajuara për çdo shoqëri, MSG dhe AlbEITI të marrin prej tyre konfirmimin për publikim për çdo raportim të dorëzuar nga shoqëritë. Ky konfirmim duhet të autorizojë institucionet qeveritare arkëtuese të paraqesin informacionin për shoqëritë përkatëse në kuadrin e raportimit EITI. Ky rekomandim vlen edhe për shoqëritë raportuese në sektorin e naftës dhe gazit, të cilat kanë pranuar vullnetarisht të bashkëpunojnë për raportimin EITI nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit. Gjithashtu rekomandohet që Sekretariati EITI në Shqipëri të bashkëpunojë ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të integruar kërkesat për raportimin kontekstual dhe individual në kuadrin e zbatimit të EITI në sistemin e ri tatimor. Ky ndryshim do të kërkojë bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave dhe mbajtjen e një regjistri publik të të liçensuarve në industrinë nxjerrëse. Ky regjistër duhet të azhornohet dhe raportohet ne kohë reale tek institucionet qeveritare që mbledhin dhe administrojnë taksat.

Bashkëpunimi më Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mund të ndihmojë në kapërcimin e kësaj barriere për taksat që mblidhen dhe administrohen në nivelin e Qeverisjes Qëndrore.

Kontributi fiskal mbledhur nga bashkitë dhe komunat nga industria nxjerrëse regjistrohet në nivelin e qeverisjes vendore dhe Ministria e Financave nuk mban të dhëna të detajuara për këto të ardhura.

Administratori Pavarur Deloitte Albania shpk rekomandon që MSG dhe EITI Shqipëri të bashkëpunojnë me NjQV-të dhe të shohin mundësinë për të përfshirë kërkesat për raportimin EITI në sistemin e menaxhimit të infromacionit të NjQV-ve. Prodhimi i informacionit të azhornuar nga sistemi i informacionit të Qeverisë do të përmirësojë statistikat në këtë sektor dhe do të mund të krahasohet me informacione të tjera si niveli i prodhimit, struktura e industrisë, numri i të liçensuarve etj.

Kjo do të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e informacionit financiar të prodhuar për aktivitetin e shfrytëzimit të burimeve natyrore në Shqipëri.

Gjithashtu, përkrah përmbledhjes së vetë-deklarimeve të dorëzuara nga shoqëritë, rekomandohet që AKBN të paraqes gjithashtu një krahasim të prodhimit të deklaruar me matjet e bëra nga AKBN në fund të çdo viti për të saktësuar bilancin e prodhimit faktik të raportuar.

Rekomandimi 2 Forcimi i aksesit në të dhëna cilësore dhe të besueshme

Në mënyrë që të lehtësohet puna rakorduese dhe raportuese, sugjerohet nga Deloitte Albania, caktimi i një skeduli vjetor për proçesin e rakordimit si në vijim: përditësimi, publikimi i formularëve dhe udhëzimeve si dhe përzgjedhja e subjekteve raportuese dhe caktimin e një afati për dorëzimin e deklaratave dhe punës rakorduese.

Fillimi i muajit maj në vitin kalendarik në vijim mund të përcaktohet si afat për dorëzimin e formularëve dhe puna rakorduese nga administratori i pavarur të kryhet në muajt maj dhe qershor të çdo viti.

5 Ndonjë pikë e fortë ose dobësitë e identifikuara në proçesin EITI

Pikat e forta

Njohja dhe bashkëpunimi më i plotë me shumë institucione shtetërore forcoi marrëdhëniet, punën dhe proçesin EITI në Shqipëri. Faqja e re e website EITI Albania dhe përdorimi i tij ka rritur nivelin e njohjes, bashkepunimit, shkëmbimit dhe funksionit të të dhënave në mënyrë transparente.

Dobesite

Sekretariati Shqiptar EITI ka një buxhet të vogël. Kjo përbën një sfidë të vërtete për të, pasi zvogëlon shumë mundësinë e promovimit në aspektin e zbatimit të strategjisë së komunikimit dhe publicitetit.

6 Kostoja totale e implementimit

Sekretariati Shqiptar EITI për vitin 2014 u mbulua nga fondet e Buxhetit të Shtetit si dhe nga fondet e Bankës Botërore. Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2014 për Sekretariatin ishte në nivelin e 10.8 milion lekë. Grandi i Bankës Botërore për vitin 2014 financoi kryesisht realizimin e Raportit EITI 2011 dhe EITI 2012 etj. Stafi faktik i Sekretariatit Shqiptar EITI për periudhën 2014 ka qënë me 9 (nëntë) punonjës. Është për tu përmendur që edhe këtë vit Presenca e OSCE në Shqiperi i ka dhënë mbështetje disa prej aktiviteteve të Sekretariatit duke financuar shoqërinë civile EITI.

Më poshtë një informacion i detajuar për vitin 2014.

Fondi Buxhetor

Parashikimi 10,800,000 mijë lekë

Realizuar 10,742,597 mijë lekë (ose 99.5%)

Fondi i Detajuar Sipas Zërave

A. Pagat

Parashikimi 10,000,000 mijë lekë

Realizuar 7,494,994 mijë lekë

B. Sigurimet

Realizuar 2,893,109 mijë lekë

C. Shpenzime të tjera Operative

Donator 2,263,957 mijë lekë

Buxheti Shtetit 327,494 mijë lekë

Fondi nga Donatorët

Banka Botërore 87,270$

7 Ndonjë koment shtesë

Fokusi kryesor i Sekretariatit Shqiptar EITI ka qënë publikimi në kohë i dy Raporteve EITI 2011 dhe 2012. U bë një punë e madhe duke nxitur secilën palë të interesuar për të qënë pjesë e këtij proçesi transparence në industrinë nxjerrëse. Theksojmë që Ministria e Energjisë dhe Industrisë ishte faktori kyç në publikimin me sukses të të dy Raporteve EITI. Thirrjes që ajo i bëri shumë institucioneve shtetërore për të bashkëpunuar me Sekretariatin Shqiptar EITI, motivoi për ta vazhduar këtë Nismë me më shumë përkushtim për vitet e ardhshme.

8 Është diskutuar veprimtaria e raportit përtej MSG-së

Raporti i Aktivitetit Vjetorë 2014 u diskutua në MSG me të tre grupet kryesore të proçesit EITI, Qeverinë, Kompanitë dhe Shoqërinë Civile. Duhet theksuar se janë marrë në konsiderate të gjitha sygjerimet e ndryshme nga secila palë e interesuar.

9 Detaje mbi antarësinë e MSG gjatë periudhës

Siç u përmend edhe më lartë, disa nga anetarët e MSG, duke marrë angazhime të reja u larguan nga Bordi EITI dhe u zëvendësun me anetare të rinj. Detyra kryesore e anetarëve të Bordit EITI ishte përshpejtimi i proçesit të publikimit të dy Raporteve EITI. Bordi EITI në muajin Janar të vitit me konsensus miratoi kufirin e materialitetit për kompanitë deklaruese në nivelin e 750.000$. Për të përshpejtuar proçesin e raportimit, u vendos që mënyra dhe metoda e proçesit të prokurimit për shërbimin e konsulencës, të jetë e përbashkët për të dy Raportet EITI 2011 dhe 2012, duke respektuar rregullat dhe proçedurat përkatëse të Marrëveshjes së Grandit mes Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore. Deloitte Albania u përzgjodh kompania fituese për rakordimin e të ardhurave tatimore dhe jo-tatimore nga Industria Nxjerrëse në Shqipëri si pjesë e zbatimit të Nismës EITI. Numri i anetarëve të MSG edhe për vitin 2014 ka qënë 5 përfaqësues nga shoqëria civile, 5 përfaqësues nga kompanitë dhe 7 përaqësues nga qeveria përfshirë dhe kryetarin e MSG. Duhet theksuar se numri i vëzhguesve të jashtëm pa të drejtë vote është shtuar ndjeshëm për gjatë vitit.

E aprovuar nga MSG:

Datë: _____

Foto të aktiviteteve

Shqipëria Publikon Raportin EITI 2012

300 Ditët e Energjisë dhe Industrisë

Forum: Promovimi i EITI dhe përfitimet për komunitetet Vendore

Seminar Trajnues Deloitte Albania

Takim në Bulqizë

Takim në Patos